

AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQERISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
OVAL SOLUTIONS Shpk

Ne Tiranë, sot në datë 21/02/2022:

Me cilësinë e "Ortakut themelues"

Z.Fatjon Seitaj, atësia Rakip, i datëlindjes 28.02.1991, lindur ne Fier dhe banues në Tiranë , shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartes se identitetit me nr 034683946 dhe me nr.personal J10228026L ,

Me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, ka redaktuar këtë statut të Shoqërisë "OVAL SOLUTIONS " shpk, në respekt dhe bazuar :

Në Kushtetutën e Republikës së Shqiperisë dhe Kodin Civil në fuqi;

Në ligjin 9901 dt 14.04.2008, "Për tregtarët dhe Shoqërite tregtare ";

Në ligjin "Për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit ", në atë doganor ,Fiskal e Tatimor;

Kanë themeluar një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "OVAL SOLUTIONS " .

**KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Emërtimi

Shoqëria gëzon emrin OVAL SOLUTIONS shpk dhe është person juridik i të drejtës shqiptare ,shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Selia

Shoqëria e ka selinë në adresën Rruga "Besim Imam", Njesia Nr 7, Ndertesa nr 5, kati 0,Hyrrja nr 16, Tirane. Shoqeria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqiperisë, vetëm me vendim të Ortakëve.

Neni 3

Objekti I Veprimitarisë

Objekti i veprimitarisë së Shoqerisë do të jetë : Shitje pajisje kompjuterike,Eksport-Import si dhe tregti me shumice dhe pakice te pajisjeve elektronike/informatike, telekomunikacionit,sisteme vezhgimi, akses kontrolli,sisteme kunder zjarri,UPS , pjese te ndryshme kembimi,aksesore,servis te pajisjeve elektronike,si dhe tregti me shumice dhe pakice te mjeteve kancelarike sherbime te printimit dhe dizanjit. Instalim,sherbim, mirembajtje te sistemeve kompjuterike,telekomunikacioni,sisteme vezhgimi,akses kontrolli,sisteme UPS, sisteme zjarri,sisteme elektrike te fuqive te larta dhe te

mesme, aplikim grafik. Tregtimit dhe sherbimit te kondicionereve. Shitje, mirembajtje dhe servisim i pajisjeve kinematografike, artistike dhe pajisjeve muzikore, audio-vizive, sherbime dhe shitje ne fushen e pasurive te paluajtshme, Mobilje dhe Pajisje per zyra, vleresime pasuri te paluajtshme, vleresim asetesh dhe sherbimet mbeshtetese ne pronat e paluajtshme, suporte dhe sherbime financiare, sherbime te standarteve financiare, shitje dhe asistence ne softe dhe programe financiare per ente publike dhe private, mirembajtje sistemeve kompjuterike te lidhura me to. Eksport import dhe tregtim i sistemeve per perpunimin e te dhenave te te gjitha llojeve, hardware, software dhe te gjithe periferikeve te tyre. Import eksport dhe tregtim aparaturash te te gjitha llojeve per zyra, pajisje zyrash e te tjera mjete pune kancelarike duke perfshire edhe te gjitha llojet e letres e materiale te tjera botimi, import eksport dhe tregtim te konsumablave per pajisje te ndryshme, tonerave, Montim aparaturash te sipermendura, parametrizimi, konfigurim. Sherbime transmetimi te dhenash, informacione dhe sherbime te ndryshme te lidhur me internetin dhe telefonine. Zhvillim software, instalim, adoptim. Mirembajtje te aparaturave te sipermendura, suport teknik, konsulencë gjithfarellojesh. Ofrues te sherbimeve te printimit, qeradhenie dhe tregtim te pajisjeve te printimit dhe hardware, menaxhim te sistemeve te printimit Pay Per Use dhe Pay Per Print. Importim dhe instalim pajisje elektronike monitorimi CCTV, pajisje elektronike per monitorimin e transportit rrugor, ajror, dhe detar si: radar, ANPR, kamera, etj. Importimi dhe instalim i pajisjeve elektronike te nevojshme per ndertimin e sistemeve te sigurise fizike te objekteve dhe sistemeve te sigurise publike ne aeroporte, banka, mbikeqyrje te qyteteve, ndertesa komerciale, transport public, infrastruktura kritike, arsim, shendetesi, stadiume, qendra te kujdesit shendetesor etj. Import - eksport te mallrave me perdonim te dyfishte, mallrave Industrial, maskave antigas etj. Projektim, ndertim dhe mirembajtje ne fushen e rrjete WAN/LAN, Wep-site etj. Tregtim, instalim te laboratoreve didaktik, shkencore, profesionale. Zhvillim dhe implementim te sistemeve te informacionit gjeografik (GIS), rregjistrim te pasurive te paluajtshme, planifikim urban, hartografi dhe matje topogeodezike. Hostim i faqeve te aplikacioneve. Projektim, ndertim dhe implementim i Data Center. Sherbime transmetimi te dhenash, informacione dhe sherbime te lidhur me internetin. Implementin dhe tregtim impiante dhe te ndryshme lidhur me to. Studime, kerkime dhe analiza te tregut, studim tregut, market research, studime demografike, sjellje klientesh, tendencash ne treg, fuqie blerese, etj analiza, studime e kerkime lidhur me to. Ofrimi i sherbimeve te akomodimit hoteleri dhe transport, Sherbime ne fushen e turizmit dhe udhetimeve, "Incoming & Outgoing Tour Operator". Projektim, ndertim, rikonstrukcion, mirembajtje, mbikqyrje, kolaudim, te veprave civile dhe industriale. sherbime dhe mirembajtje te mjeteve te transportit, Tregetimi i materialeve te pastrimit, materialeve hidraulike dhe elekrike, bimeve medicinal dhe ilaceve mjekesore. sherbimi i ofrimit te internetit, sherbim rikonstrukzioni dhe lyerje godine si dhe cdo lloj aktiviteti qe nuk eshte i ndaluar nga ligji ne fuqi.

#### Neni 4

#### Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar , duke filluar nga data e rregjistrimit pranë Qëndrës Kombëtare të biznesit. Vendosja e mëpasshme e një kufizimi në kohë është kompetencë e mbledhjes së Ortakëve të Shoqërisë .

#### KREU II KAPITALI

#### Neni 5

#### Kapitali Themeltar



Kapitali Themeltar i pataksueshëm i Shoqërisë është 100,000 leke dhe është i ndarë ne 1kuote te barabarte, vlera nominale e se cilës është 100,000 leke .Kapitali i mesipërm zotërohet nga Ortaku i Shoqërisë ne reportin:

Z. Fatjon Seitaj, i cili zoteron 100% te kapitalit, ose një kuote .

Pjesët e Kapitalit Themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme . Kontributi i Ortakëve edhe pse mund të jetë edhe në natyrë (pasuri të luajtshme/te paluajtshme apo të drejta) është në para (cash).

#### Neni 6

##### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i Shoqerisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të Kapitalit Themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë apo financime në cash, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar per këto kontributë në mënyrë sipas kërkesës së administratorit.

Posti financime ortakë në shoqëri bazuar në reportin e ekspertit kontabël do të përdoret pa kushte përritjen e kapitalit themeltar në vlerë dhe në kuota ,kjo në përpjestim me financimin e cdo njërit prej ortakëve dhe me efekt ndryshimin e pjesëve ne kapital. Në rast mosbatimi te kërkesave të këtij parografi, cdo njëri prej ortakëve, apo personi i interesuar mund të kërkojë këtë të drejtë në rrugë gjyqësore.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Ortakëve në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin të nenit përkatesë të statutit, kapitali fillestar është i pataksueshëm. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë perpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve thirrur per të marrë vendim rreth ketij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e ben të detyrueshme marrjen e një vendimi prej Shoqërisë per zmadhimin e kapitalit themeltar të pakten deri në vlerën minimale. Ne rast mosbatimi të kërkesave të këtij parografi, cdo person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e Shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

#### Neni 7

##### Transferimi i kapitalit ndermjet Ortakëve apo në persona të tretë

Kuotat e kapitalit të një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet

a) kontributit në kapitalin e Shoqërisë

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

d) dhurimit;

e) cdo mënyrë tjeter të parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim e nenshkruar



personalisht nga dhe vetëm prej Ortakut përfaqësues apo personit të prokuruar prej tij, përpara një Noteri.

Kuotat për shitje I propozohen më parë respektivisht Ortakëve të Shoqërisë për një afat 30 ditë, pas kalimit të këtij afati ato janë lirisht të transferueshme ndaj cdo personi të interesuar.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi I kuotës, nga casti i kalimit të kuotave deri në castin e rregjistrimit të kalimit të saj ne Qendrën Kombetare të Biznesit sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi I kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

#### Neni 8

#### Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakëve është organi vendimarrës I Shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

#### Asambleja e Ortakëve, vendos dhe përgjigjet për cështje si:

- përcaktimi I politikave tregtare të Shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve;
- mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve periodike të ecurisë së veprimtarisë;
- përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakëve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në vecanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- investime, transferime kuotash, etj;
- vendimet për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve apo te papublikuara në regjistrin tregtar ne QKB, janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'kundrejtojë pavlefshmerinë të tretit, që ka fituar të drejtat në mirëbesim, përvèc rastit kur Shoqëria provon se I treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 9

#### Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve

Nëse nuk përcaktohet një vend tjetër, Asambleja e Ortakëve I mban mbledhjet e saj në selinë e Shoqërisë.



Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve do të mbahen jo më pak se 2 (dy) herë ne vit, ose mbledhja pasardhëse e Asamblesë së Ortakëve do të jetë me një distancë kohore jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga mbledhja paraardhëse.

Çështjet që kërkojnë miratimin e Asamblesë së Ortakëve mund të komunikohen me postë të zakonshme apo edhe me postë elektronike (email) dhe keto komunikime janë të vlefshme kur konfirmohen dhe nënshkruhen nga Ortakët, anëtarë të Asamblesë.

Thirrja dhe vendimet e Asamblesë së Ortakëve janë të vlefshme kur procedurat kryhen në përputhje me Ligjin e Shoqërive Tregtare. Nëse, si rrjedhim i thirrjes së parë të Asamblesë, nuk realizohet kuorumi i nevojsphem, mbledhja e Asamblesë do të shtyhet për një herë të dytë në distancë kohore prej 10 ditësh nga e para dhe, në rast se edhe në këtë mbledhje të dytë mungon vendimmarrja, Ortakët pranojnë vlerësimin e kuotave (cmimin për shitje) brenda një afati prej 7 ditësh dhe më pas ofrojnë kalimin e tyre midis njëri-tjetrit, sikurse është theksuar në Nenin 7 këtu, me një afat brenda 30-ditësh. Pas kalimit të afatit prej 37 ditësh kuotat bëhen lirisht të transferueshme për shitje kundrejt cdo personi të interesuar për to.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë dhe materialet për diskutim, nisen me postë fizike (postë të zakonshme) ose elektronike, minimum 7 dite para datës kur do zhvillohet mbledhja e radhës. Kur të gjithë Ortakët janë dakort, mbledhja mund të zhvillohet në cdo datë.

Ortakët, me vendim Asambleje, depozitojnë pranë Shoqërisë adresat e postës elektronike ku duan të marrin dhe nga ku do tu per gjigjen komunikimeve të Shoqërisë. Ndryshimet e adresës së postës elektronike duhet ti komunikohen më parë po me postën elektronike ose me anë të sherbimit postar rekomande Administratorit të Shoqërisë dhe deri kur komunikimi për ndryshimin e adresës elektronike nuk ka mbërritur, do konsiderohet e vlefshme adresa ekzistente në arkivat e Shoqërisë.

#### Neni 10

#### Administrimi

Emërimi i Administratorit të Shoqërisë është kompetencë e Asamblesë së Ortakëve e cila vendos me rotacion njëvjecar apo për një kohë më të gjatë, emërimin e cdo njërit prej ortakëve apo edhe të personave të tretë në postin e administratorit si drejtues i shoqërisë.

Administrator i parë i Shoqërise emërohet për një afat te përcaktuar, deri 31.12.2022 me të drejtë riemërimi Z. Elvis Gjonaj, atesia Mikel, i datelindjes 02.06.1988, lindur ne Rreshen dhe banues në Tirane (në adresën: Selite, Rruga Eduard Mano, Vreshte, Zona Kadastrale nr.3292, nr pasurie 153/84/1, Kati 1, Tirane), shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi të plotë juridike e për të vepruar, me nr. personal I80602052D.

Administratori ka kompetenca, mban pergjegjësi dhe ka për detyrë:

- të zbatojë politikat tregtare të Shoqërisë
- të pergatisë me shkrim dhe të dokumentojë kërkesat e Asamblesë së Ortakëve, marrjen e masave që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e Asamblesë.



- të thërrasë mbledhjen e Asamblesë sa herë vlerësohet e nevojshme, për interesa operative apo afatgjata të Shoqërisë apo masa të tjera të nevojshmë e të përshtatshme;
- të kujdeset që Shoqëria të respektojë ligjin dhe standartet e kontabilitetit;
- të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e Shoqërisë;
- të sigurojë që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen për t’iu paraqitur Asamblesë së Ortakëve, së bashku me një raport të administrimit për miratimin dhe një pëershkrim për mbikqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit finanziar.
- të sigurojë që auditimi i librave dhe i regjistimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabël të autorizuar, rapporti i auditimit t’u vihet në dispozicion Asamblesë së Ortakëve;
- t’l propozojë Asamblesë së Ortakëve organigramën, personelin e punësuar dhe shpërblimet si dhe cdo kontratë për punë me kohë të pjesshme apo shërbime që kërkon Shoqëria;
- shpërblimi i Adminisrtatorit është kompetencë e Asamblesë së Ortakëve;
- të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në Statut;
- të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërise ;
- të kryejnë regjistimet dhe publikimet e detyrueshme të të dhënavë të Shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera.

#### Neni 11

#### Inventari. Pasqyrat dhe Viti Financiar

Viti finansiar fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti. Përjashtimisht viti i parë finansiar do të fillojë në datën kur Shoqëria është regjistruar dhe mbaron më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

Ne perfundim të cdo viti finansiar, Administratori përgatit inventarët, pasqyrat financiare dhe raportin gjithëvjetor të administrimit, në perputhje me dispozitat e legjisacionit në fuqi mbi kontabilitetin . Po ne vijim Administratori dhe konsulentët finansiar, që kontaktohen nga Shoqëria, pasqyrojnë në analizë shpenzimet dhe risqet fiskale, planifikojnë buxhetet vjetore dhe i propozojnë Asamblesë së Ortakëve politika për të ardhmen e Shoqërisë.

Fitimi neto i realizuar që ka rezultuar pas zbritjes së shpenzimeve si dhe vlerës së fondit rezervë, u kalon Ortakëve në përputhje me përqindjen e kontributit të tyre në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë ose mund të kalojë për investime, por gjithmonë bazuar në një vendim të shkruar të Asamblesë së Ortakëve.

Mbartja afatgjatë e detyrimeve financiare të Shoqërisë kundrejt të tretëve,institucioneve bankare apo individëve ndalon Asamblenë e Ortakëve në ndarjen e dividentëve me prioritet përmirësimin e gjendjes financiare të Shoqërisë dhe rritje të përgjegjësisë dhe përparësisë për fondet që Shoqëria mobilizon për aktivitetin e saj tregtar kundrejt të tretëve duke i dhënë përparësi këtyre të fundit. Mbledhja e

Asamblesë së Ortakëve ka të drejtë dhe mund të krijojë edhe lloje të tjera fondesh, apo rezervash përvec fondevet e parashikuara këtu.

Neni 12

Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua ne 3 (tre) ekzemplarë me vlera të njëjta juridike në gjuhen shqipe dhe, pasi iu lexua Ortakut, nenshkruehet me vullnet të lirë nga Administratori dhe Ortaku themelues.

Shoqëria OVAL SOLUTIONS shpk

ADMINISTRATORI

ELVIS GJONAJ



ORTAKU

Fatjon Seitaj

